

RUDINA TODRI (MITA)

## VËSHTRIM MBI VEPRIMTARINË POLITIKE TË SHEFQET VËRLACIT\*

### Fëmijëria dhe shkollimi i Shefqet Vërlacit

Tashmë është e njohur se Shefqet Vërlaci ka qenë një nga figurat më të rëndësishme politike, shoqërore dhe ndër pronarët më të mëdhenj të trevës së Elbasanit, madje dhe në shkallë kombëtare gjatë periudhës 1912-1943. Megjithatë, ndonëse është njohur sadopak veprimtaria dhe roli historiko-politik e shoqëror i kësaj figure në proceset e zhvillimeve politike shqiptare, nuk është bërë objekt studimi i posaçëm nga që gjatë periudhës së monizmit Shefqet Vërlaci është konsideruar bashkëpunëtor i fashizmit dhe tradhtar i vendit<sup>1</sup>. Edhe në rastet kur është përmendur ai dhe veprimtaria e tij është paraqitur e shtrembëruar, madje është paragjykuar duke e vlerësuar me njëanshmëri si figurë negative.

Duke pasur parasysh faktin e mësipërm, dhe nga ana tjetër e prirur për të nxjerrë në dritë të vërtetën historike vendosa të shkruaja për këtë figurë politike jo shumë të trajtuar në histori, madje mund të thuhet thuajse të lënë në harresë të plotë.

Shefqet Ismail Vërlaci rridhte nga një familje e pasur në trevën e Elbasanit e më gjerë, krahas familjeve të tjera si Biçakçiu, Miraku, Harja etj. Shefqeti lindi më 15 dhjetor 1877 në qytetin e Elbasanit. Arsimin fillor e kreu në Elbasan, më pas u vendos në qytetin e Manastirit ku mori edhe arsimin e mesëm. Arsimin e lartë e nisi në Stamboll në shkollën e lartë Mylqije, por nuk e përfundoi.

Përveç prejardhjes familjare, pasurisë dhe prestigjit në qytetin e Elbasanit dhe në rrethinat e tij, Shefqet Vërlaci u bë i njohur edhe në mbarë vendin jo vetëm për shkak të rritjes së vazhdueshme sidomos të pronësisë tokësore, tipar dallues i shtresës së cilës i përkiste, por edhe në aspektin politik nga që u përfshi qysh herët në jetën politike të vendit.

### Përfshirja e Shefqet Vërlacit në jetën politike të vendit

Në vitin 1910 Shefqet Vërlaci u zgjodh deputet i Elbasanit në Parlamentin e Perandorisë Osmane. Marrëdhëniet e tij me administratën

---

\* Ky artikull synon të evidentojë dhe të analizojë veprimtarinë politike të një prej figurave kryesore të jetës politike dhe ekonomike të trevës së Elbasanit dhe më gjerë, të Shefqet Vërlacit, pushteti dhe prezenca e të cilit ndihej e ndikonte dukshëm jo vetëm në gjithë jetën politiko-shoqërore brenda qytetit e krahinave të Elbasanit, por edhe në rrafsh kombëtar. Në artikull pasqyrohen në detaje anë të panjohura deri tani, sidomos të veprimtarisë politike të kësaj figure të rëndësishme të kohës. Gjithçka shqyrtohet e analizohet mbi bazën e objektivitetit shkencor e të vërtetësisë historike (autorja).

<sup>1</sup> *Historia e Shqipërisë*, vëll. III, Tiranë: 1984, f. 482.

osmane të kohës shkuan deri diku mirë. Vetëm gjatë zhvillimit të ekspeditës së Turgut Pashës në Shqipëri, si pasojë e një konflikti me të u detyrua të arratisesh për njëfarë kohe jashtë Shqipërisë. Shyqyri Demiri në veprën e tij “Histori e shkurtër e trevës së Elbasanit” lidhur me këtë çështje thekson: “Turgut Pasha ndaj elementëve patriotë e përparimtarë u soll çnjerëzor... Disa bejlerë u paralajmëruan me kohë dhe dolën jashtë shtetit, si: Aqif Biçaku, Shefqet Vërlaci etj.”<sup>2</sup>

U kthye në vendlindje në verë të vitit 1912, gjatë kohës kur kishte marr hov zhvillimi i kryengritjes së përgjithshme antiotomane të popullit shqiptar.

Më 1912-ën, Shefqet Vërlaci, bashkë me parinë elbasanase, e përkrahu dhe e përshëndeti Shpalljen e Pavarësisë në Vlorë, të cilën e vlerësoi dhe e çmoi si ngjarje kulmore politike e historike për vendin.

Sikurse dihet pas Shpalljes së Pavarësisë, aktiviteti i qeverisë së Vlorës vazhdoi deri në janar të vitit 1914, më pas funksionet qeverisëse i mori Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit. Më 1914, Shefqet Vërlaci bashkë me Lef Nosin dhe Ahmet Hostopallin ishin pjesëtar të delegacionit shqiptar që u dërgua nga Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit në Noj Vid (Neu Wied) të Gjermanisë, ku më 21 shkurt 1914 i dorëzoi zyrtarisht Vilhelm Vidit kurorën e princit të Shqipërisë,<sup>3</sup> duke i shprehur dëshirën dhe shpresën për t’u parë sa më parë në Shqipëri.

Gjatë viteve të Luftës së Parë Botërore 1914-1918, Sh. Vërlaci ndodhej jashtë Shqipërisë. Sipas të dhënave të disa burimeve të kohës thuhej se vendndodhja jo vetëm e tij, por edhe e shumë përfaqësuesve nga dyert e mëdha shqiptare ishte jashtë vendit. Kryengritja e Shqipërisë së Mesme dhe rreziku i fillimit të luftës ndikoi ndjeshëm në këtë largim të tyre. Gjatë kryengritjes në Shqipërinë e Mesme, rebelët ia dogjën shtëpinë Sh. Vërlacit në Elbasan, ashtu siç ndodhi me pjesën më të madhe të pronave të shumë prej personaliteteve më të njohura në vend. Për shkak të rrethanave dhe kaosit që u krijuan asokohe në vend elita politike shqiptare për t’i shpëtuar rreziqeve që e kanosnin u detyrua të largohej nga Shqipëria e shkoi në vende të ndryshme të Europës.

Rreth këtij problemi Eqerem bej Vlora në librin e tij “Kujtime” (1912-1925) ndër te tjera thekson: “Dalëngadalë gjithë elita e ikanakëve shqiptarë u mblodh në Napoli dhe aty ajo harxhonte florinjte e fundit në hotelet më të mira të qytetit. Kishte aty një mori Vrionësh, Toptanësh, Vërlacësh, Biçakësh, Libohovash, Vlorash dhe të tjerë, që ishin të bindur se po bënin një jetë të përkorë në Grand Hotel, në hotel Riviera apo në hotel Bertolini, pa kuptuar se me një të dhjetën e këtyre shpenzimeve do të mund t’a kalonin tërë jetën denjësisht e pa u munguar asgjë”<sup>4</sup>.

<sup>2</sup> Shyqyri Demiri, *Histori e shkurtër e trevës së Elbasanit*, Tiranë: 2006, f. 115.

<sup>3</sup> *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. III, botim i Akademisë së Shkencave, Institutit i Historisë, Tiranë: “Toena”, 2007, f. 58.

<sup>4</sup> Eqerem bej Vlora, *Kujtime (1912-1925)*, Tiranë: 2001, f. 117.

### **Kthimi në At dhe - pjesëmarrja në Kongresin e Durrësit dhjetor 1918**

Pas kthimit në at dhe Shefqet Vërlaci u zgjodh delegat dhe përfaqësues i popullit të prefekturës së Elbasanit në Kongresin e Durrësit më 25 dhjetor 1918. Mbështeti dhe përkrahu Qeverinë e Turhan pashë Përmetit, që krijoi ai kongres. Qëndrimi i tij ndaj qeverisë së Durrësit dhe programit politiko-ekonomik të saj përcaktohej nga interesat e tij. Ai përkrahte dhe mbronte qëndrimin proitalian të asaj qeverie nga që interesat e tij ekonomike ishin të lidhura ngushtë me shtetin fqinj.

Vërlaci në sajë të mbështetjes që kishte tek italianët, mundi të shtjerë në dorë administratën e bashkisë (katundarisë-shënimi im) së Elbasanit. Menjëherë pas saj nisi përpjekjet të shtinte në dorë edhe administratën e prefekturës, por hasi në kundërshtimin e prefektit Abdyl Ypi. Por në saj të përpjekjeve të vendosura dhe mbështetjes italiane Shefqet Vërlaci ia arriti qëllimit, rrëzoi Abdyl Ypin dhe postin e Prefektit të Elbasanit ia dha baxhanakut të vet Feim Leskovikut. Në këtë mënyrë Shefqet Vërlaci vuri nën kontrollin e plotë të tij gjithë administratën shtetërore të Elbasanit.

Sikurse dihet, pas mbarimit të Luftës së Parë Botërore u mbledh në Paris Konferenca e Paqes në punimet e të cilës qarqet shoviniste fqinje të përkrahura edhe nga Fuqi të Mëdha Europiane hartonin plane për copëtime të reja e të mëtejshme të tokave shqiptare. Qarqet patriotike shqiptare, sapo morën vesh planet antishqiptare që thureshin kundër vendit tonë në Konferencën e Paqes, e vlerësuan me seriozitetin më të madh rrezikun që i kanosej vendit. Në ato rrethana të rënda për vendin, kur vihej në rrezik tërësia territoriale dhe integriteti e sovraniteti i shtetit shqiptar, qarqet atdhetare nisën të merrnin një varg masash politike dhe ushtarake. Mbi të gjitha ato vendosën të organizonin një Kongres, në të cilin të përfaqësohej populli i tërë krahinave të vendit, ku do të shqyrtonin masat që duheshin marrë për përballimin e situatës së rëndë në të cilën ndodhej atdheu.

### **Qëndrimi i Shefqet Vërlacit ndaj Kongresit të Lushnjës**

Në fillim u hodh ideja që kongresi të mbledhej në Elbasan. Por kjo nuk u realizua sepse hasi në kundërshtimin e drejtuesve të Bashkisë së Elbasanit, të cilët ishin përkrahës të Qeverisë së Durrësit dhe mbi ta kishte ndikim shumë të madh Shefqet Vërlaci. Madje Shefqet beu "... nuk ishte aspak dakord për mbajtjen e një kongresi të tillë pasi siç e përmendëm më sipër ai ishte përkrahës i Kongresit të Durrësit"<sup>5</sup>. Nga ana tjetër në qëndrimin e tij kundër mbajtjes së kongresit në qytetin e Elbasanit ka ndikuar edhe fakti që rivali i tij Aqif Pasha

<sup>5</sup> P. Kita, *Elbasani në luftë për çlirim*, Tiranë: 1974, f. 36.

ishite ndër nismëtarët më të vendosur të thirrjes së kongresit dhe kundërshtar i njohur i Kongresit të Durrësit. Kjo u shpreh hapur dhe publikisht nga Shefqet Vërlaci, i cili me anë të Prefekturës së Elbasanit bëri gjithë përpjekjet e mundëshme për ta penguar Aqif pashë Biçakçiun të merrte pjesë në Kongresin e Lushnjes. Në atë kohë dihej se ata të dy ishin kundërshtar të hapur të njëri-tjetrit, ndonëse vinin nga e njëjta shtresë sociale. Idetë, pikëpamjet dhe qëndrimet e tyre ndaj problemeve politike që kishte vendi ishin të ndryshme dhe të kundërta. Ky fakt ishte shkaku kryesor që Shefqet Vërlaci në bashkëpunim me prefektin e Elbasanit Fehim Leskovikun, i cili në atë kohë banonte në shtëpinë e Vërlacit dhe për këtë arsye midis tyre ekzistonte një lidhje e fortë, organizuan punën në mënyrë të atillë që Aqif Pasha të mos ishte në listën e delegatëve që do të përfaqësonin popullin e Elbasanit në kongres. Ata mendonin dhe u përpoqën që me çdo mënyrë ta pengonin Aqif Pashën të merrte pjesë në Kongres. Por pavarësisht nga këto pengesa dhe për këto arsye kandidatura e Aqif Pashës mbeti e fshehtë deri në momentin e mbledhjes së kongresit, ku ky i fundit mori pjesë dhe përfaqësonte nënprefekturën e Peqinit. “Bashkia e rrethit Elbasan ndodhej nën ndikimin e Shefqet Vërlacit, influenza e të cilit ka qenë aq e madhe sa Aqif Pasha mori pjesë në Kongres jo si delegat i Elbasanit, por si delegat i Peqinit”<sup>6</sup>, shkruajnë dokumente të kohës.

**Senator i Elbasanit në Këshillin Kombëtar  
të vitit 1920 dhe më pas deputet i Elbasanit  
në Parlamentin e parë pluralist shqiptar (1921-1923)**

Kongresi i Lushnjes vuri bazat e institucionalizimit të Shtetit Shqiptar. Sikurse dihet ai krijoi organet më të larta të piramidës shtetërore. Në Kongresin historik të Lushnjes, Elbasani dhe rrethinat e tij u përfaqësuan nga disa persona të njohur në këtë trevë. Në këtë kongres Shefqet Vërlaci nuk mori pjesë, sepse ai e kundërshtonte organizimin dhe mbajtjen e këtij kongresi, ngaqë ai ishte përkrahës i Kongresit të Durrësit. Kongresi i Lushnjes më 31 janar 1920 e zgjodhi Shefqet Vërlacin senator të Elbasanit në Këshillin Kombëtar<sup>7</sup>. Zgjedhja e tij si senator i trevës së Elbasanit duket u bë nga që ai tashmë ishte personalitet i njohur që kishte autoritet dhe ndikim në këtë trevë. Megjithëse u zgjodh, burimet që kemi konsultuar deri tani, dëshmojnë se ai asnjëherë nuk mori pjesë në Këshillin Kombëtar që doli nga Kongresi i Lushnjes.

Shefqet Vërlaci mori pjesë gjerësisht dhe fitoi në zgjedhjet e para parlamentare të 5 prillit 1921 dhe u zgjodh deputet që do të përfaqësonte popullin e Elbasanit në parlamentin e parë pluralist shqiptar që nisi punën në

<sup>6</sup> *Po aty.*

<sup>7</sup> Teki Selenica, *Shqipëria më 1937*, vëll. I, Tiranë: 1937, f. 48.

pranverë 1921. Gjatë fushatës elektorale të zgjedhjeve ai ishte dhe lideri i grupimit politik “Pleqësor” të formuar në trevën e Elbasanit.

### **Veprimtaria parlamentare e Shefqet Vërlacit**

Gjatë vitit 1921 fillimisht bënte pjesë në Partinë Përparimtare, por pas shpërbërjes së saj Shefqet Vërlaci ndikoi tek deputetët e Elbasanit të kalonin në formacionin e quajtur “Partia Kushtetuese”, ndërsa gjatë vitit 1922 ai është ndër emrat kryesorë të Partisë Popullore.

Shefqet Vërlaci ishte i pari që bëri propozimin në Këshillin Kombëtar për heqjen e titullit “bej” e zëvendësimin e tij me titullin “zotëri”.<sup>8</sup>

Në seancat parlamentare u trajtuan dhe u diskutuan probleme të ndryshme politike, ekonomike, sociale, administrative etj që kishin të bënin me forcimin dhe konsolidimin e shtetit të saporiformuar shqiptar. Duke qenë në hapat e para të parlamentarizmit në Shqipëri, Këshilli Kombëtar duhet të jepte shembullin e bashkimit e të konsolidimit të shqiptarëve. Nisur nga kjo, deputeti elbasanas, Shefqet Vërlaci nga tribuna e parlamentit bënte thirrje për bashkim. Mendimet e idetë e tij për unitet e bashkim u mbështetën dhe u përkrahën edhe nga deputetë të tjerë në parlament. Ai, duke mos e pranuar dorëheqjen e Mihal Turtullit nga Këshilli i Lartë, theksoi: “Dorëheqja përsiret përçarje dhe dihet se në ksi gjana s`kemi shoqe...gjaja qi na lypet asht të përmbamit e një qeverie dorë t`hekurt, vepruese, të drejtë, atdhetare që të kemi mbesimin e përfaqësuesvet tonë dhe të kombit”.<sup>9</sup>

Ishte deputeti elbasanas Shefqet Vërlaci, i cili gjatë punës në parlament, në një nga diskutimet e tij, paraqiti listën e deputetëve të cilët do të formonin komisionet e punëve në fusha të ndryshme, si: Komisionin për Punët e Drejtësisë, atë për Punët e Administratës dhe Ushtrisë në të cilën merrte pjesë edhe vetë, Komisionin për Punët e Arsimit, Bujqësisë, Punët Financiare dhe Postë-Telegrafët, Punët Botore.

Nuk mori pjesë në krijimin e “Bashkimit të Shenjtë”, madje që në fillim u shpreh kundër krijimit të tij sepse me sa duket, interesat e tij kërkonin që në qeveri e në krye të saj të vendoseshin përfaqësues nga shtresa e tyre shoqërore.

Me insistimin e Zogut, më 22 dhjetor 1921 u mbledh Parlamenti në Tiranë, i cili do të shqyrtonte shkaqet që kishin çuar në shfaqjen e krizave të njëpasnjëshme qeveritare (është fjala për krizat politike qeveritare të dhjetorit 1921) dhe marrjen e masave të duhura për kapërcimin e tyre. Gjatë zhvillimit të punimeve të parlamentit u vunë re përpjekjet e Shefqet Vërlacit për të bashkëpunuar me popullorët kundër Aqif Pashës.

Aktiviteti i tij politik u bë më intensiv në ngjarjet politike të zhvilluara gjatë vitit 1923.

<sup>8</sup> Kastriot Dervishi, *Elbasani-Enciklopedi*, Elbasan: 2005, f. 51.

<sup>9</sup> Gazeta *Shkumbini*, Nr. 16, Elbasan, 29 prill 1921.

Në zgjedhjet për Asamble Kushtetuese në shtator-dhjetor 1923, ai përsëri ishte lideri i grupimit të quajtur “Partia Pleqësuer” dhe njëkohësisht financuesi i gazetës lokale që dilte në atë kohë në Elbasan, e cila shprehte dhe propagandonte pikëpamjet, idetë dhe programin e grupit “Pleqësuer”. Në këto zgjedhje sërish në Elbasan fitoi Vërlaci dhe grupimi i tij politik. Ai do të përfaqësojë trevën e Elbasanit në Asamblenë Kushtetuese.

Ishte lideri i Partisë Progresive, e cila përbënte shumicën konservatore në Shqipëri, të cilët kundërshtonin kryerjen e reformës agrare, zbatimi i së cilës prekte drejtpërdrejtë interesat e pronarëve të mëdhenj të tokave, një nga të mëdhenjtë, sikurse e theksuam më lart, ishte vetë Shefqet Vërlaci.

### **Familja e Shefqet Vërlacit dhe lidhjet e saj miqësore**

Më 1922 Shefqet Vërlaci ishte pronari më madh i tokave të Shqipërisë. Sasia e pronave të patundshme të zotëruara prej tij kapte shifrën e 3700 ha. Sipas disa statistikave të kohës, Shefqet Vërlaci kishte prona të patundshme të cilat fillonin që nga Fusha Mbret e deri tek Ura e Mifolit në Vlorë.

Përveç pronave tokësore zotëronte edhe dyqane, shtëpi, mullinj bloje të cilët kishin një kapacitet bluarjeje drithi të aftë të mbulonte dhe plotësonte nevojat e disa qyteteve njëherazi. Siç shënohet në kronikat e kohës, mulliri më i madh i blojes në Shqipëri në periudhën pas Shpalljes së Pavarësisë ka qenë ai i Shefqet Vërlacit<sup>10</sup>. Sipas shtypit të kohës dhe kujtimeve të bashkëkohësve të tij mendohej se Shefqet Vërlaci përveç pronave tokësore kishte aksione në Bankën Italo-Shqiptare dhe njëkohësisht kishte dhe prona në Itali kryesisht objekte, si restorante, hotele në Napoli etj.

Si shumë dyer të mëdha dhe dera e Vërlacajve lidhi krushqi me dyer të njohura të kohës në vend. Familja Vërlaci përbëhej nga 6 persona, dy bashkëshortët, tre vajzat dhe një djalë. Djali i vetëm i Shefqet Vërlacit, ishte Ismail Vërlaci, i cili gjatë vitit 1939 pas pushtimit të Italisë shkoi me studime në Universitet, në Romë. Tre vajzat: Behija, e cila në vitin 1922 u fejuua me Ahmet Zogun, fejesë kjo që ndikoi ndjeshëm në karrierën politike e shtetërore të Shefqet Vërlacit madje ai arriti në postin e kryeministrit. Por mbas vitit 1925 me shpalljen e Ahmet Zogut, President i Republikës dhe me fuqizimin e vazhdueshëm të pushtetit të tij, fejesa u prish në vitin 1928. Mejtapi dhe Fazilet Vërlaci, kjo e fundit më 24 shkurt 1937 u martua me Ihsan Libohovën, i cili në atë kohë kishte një post të rëndësishëm shtetëror dhe vinte nga një familje e shquar. Ja si shprehet ndër të tjera shtypi i kohës lidhur me realizimin e kësaj martese: “Më 24 shkurt celebruan martesën e tyre z. Dr. Ihsan Libohova, shefi i seksionit të bashkive e komuneve pranë Ministrisë së Brendëshme, me zonjën

<sup>10</sup> Valentina Duka, *Qytetet e Shqipërisë (1912-1924)*, Tiranë: 1997, f. 30.

Fazilet Vërlaci, bija e shquar e z. Shefqet Vërlacit. Çiftit të zgjedhur i urojmë jetë të lumtur dhe trashëgime”<sup>11</sup>.

Një ndër dhëndurët e Vërlacit ishte dhe Xhemil bej Dino, diplomat i rangut të lartë që shërbeu në diplomacinë shqiptare gjatë gjithë viteve të veprimtarisë shtetërore të tij,<sup>12</sup> nga viti 1921 kur nisi punë e deri në vitet `40 të shek. XX. Si diplomat karriere ai u caktua në detyra të rëndësishme diplomatike, si përfaqësues i Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve, në Angli, në Francë, në Itali, në Rumani, në Bullgari etj. Kishte pozitë të lartë në pushtet sidomos gjatë periudhës së sundimit të A. Zogut, kur iu dha posti i ministrit të Jashtëm. Ishte një italoofil i bindur gjë që duket dhe shprehet qartë edhe në telegramin e falënderimit që i dërgoi Musolinit në momentin e pushtimit të Shqipërisë nga Italia.

### **Shefqet Vërlaci - Kryeministër**

Shefqet Vërlaci në mars të 1924 pranoi postin e kryeministrit. Kabineti Vërlaci më 3 mars parashtroi programin e qeverisë, kërkoi votëbesimin dhe Kuvendi me 53 vota pro, kundra 28 vota dhe 4 vota abstenim, i dha votëbesimin. Por gjatë mandatit në krye të këtij posti për shkak të skandaleve financiare dhe disa vrasjeve të ndodhura në vend, ai akuzohet dhe gjykohet nga Zogu si i paaftë politikisht. Me këtë akt Ahmet Zogu synonte të tregonte edhe një herë hapur në sytë e opinionit politik shqiptar dhe atij botëror, por edhe në sytë e popullit se e vetmja dorë e fortë në pushtet ishte dora e tij.

Periudha e qëndrimit të Shefqet Vërlacit në postin e kryeministrit ishte nga 3 marsi 1924 deri në 27 maj 1924. Më pas me ardhjen në pushtet të qeverisë së F.S. Nolit ai u arratis, shkoi në Itali. Gjatë regjimit të Nolit u ndoq një gjyq special i krijuar nga qeveria, në të cilin Vërlaci u dënua me vdekje në mungesë dhe iu konfiskuan pronat.

Gjatë viteve 1925-1928 në periudhën e Republikës Shqiptare, dhe Ahmet Zogut President i saj, Shefqet Vërlaci, i kthyer në Shqipëri, ishte Senator.

### **Acarimi i marrëdhënieve të Shefqet Vërlacit me Ahmet Zogun**

Acarimi i marrëdhënieve mes Zogut dhe Vërlacit, u shkaktua nga prishja e fejesës së të bijës së Vërlacit me Zogun. Si shkak tjetër të acarimit të mëtejshëm të tyre në atë kohë mendohej fakti se Vërlaci kishte dorë në vrasjen

---

<sup>11</sup> Revista *Përpyjekja shqiptare* (përmbledhje e vitit 1937), botuar nga Branko Merxhani, Tiranë, 1937, f. 147.

<sup>12</sup> Uran Asllani, *Diplomacia dhe Diplomatët Shqiptarë (1912-1944)*, Tiranë: 2006, f. 181.

që iu bë Ceno bej Kryeziut, kunatit të Zogut. Mendohej se atentatori ishte i riu nga Elbasani Alqiviadh Bebi, pas së cilit qëndronte dora e Vërlacit.

Atentati u bë më 14 tetor 1927 në kafenenë “Passage” të Pragës duke qëlluar 3 herë. Sipas Sejfi Vllamasit, Alqiviadh Bebi ishte dërguar me mision nga mik i ngushtë i Shefqet Vërlacit, Andon Beça, në bashkëpunim me elementët e emigracionit politik shqiptar ndër të cilët mund të përmendim Xhevat Korçën. Udhëtimi që kishte ndërmarrë Alqiviadh Bebi nga Elbasani-Split-Beograd-Pragë në 3 tetor 1927 e justifikonte më së miri qëllimin e këtij itinerari. Në seancën e parë gjyqësore e cila ishte dhe e fundit për të që u bë në Pragë një vit pas vrasjes së Ceno bej Kryeziut, pra më 30 nëntor 1927, Alqiviadh Bebi deklaroi se urdhrat për të realizuar këtë vrasje i kishte marrë nga një “Komiteti kryengritës”, duke mos deklaruar anëtarët e tij, gjë që hidhte poshtë hipotezën dhe mendimin se në vrasje ishte dora e Vërlacit. Në këtë seancë gjyqësore A. Bebi u vra nga shërbëtori i Ceno bej Kryeziut, 17-vjeçari Zija Vuçiterna<sup>13</sup>.

Gjatë vitit 1927 sipas dëshmisë së Andon Beçës, Ahmet Zogu i organizoi një atentat Shefqet Vërlacit për ta eliminuar. Atentati u krye pranë shtëpisë së Vërlacit që ndodhej në Tiranë. Ky atentat mendohet të jetë bërë nga vëllezërit e Ceno bej Kryeziut, më 6 dhjetor 1927 rreth orës 23<sup>00</sup>, disa minuta më vonë pas takimit të dytë me senatorin italian Becola. Por në këtë atentat kishte mbetur i plagosur Andon Beça (që ishte ndër njerëzit më besnikë të Vërlacit), i cili kishte qenë i pranishëm aty në momentin e atentatit, njëkohësisht u plagos Riza Ismaili (Karaosmani) dhe u vra Xhaferr Shaqiri<sup>14</sup>. Si provë materiale u gjetën ndër të tjera dhe një kapelë e qepur në Serbi bashkë me armën nga e cila kishin dalë plumbat dhe ishte kryer krimi, e cila doli se ishte një ndër 300 armët që kishte dhuruar Ahmet Zogu me shenjën “A.Z” dhe që i përkiste Ceno Kryeziut<sup>15</sup>.

Historia ka treguar se dora e të fortit dhe shfaqja e fenomenit të hakmarrjes apo gjakmarrjes qofshin këto të momentit apo të brezave të tërë, të fisit apo të familjes së tyre mund të ishte e pranishme në çdo moment duke patur parasysh temperamentin e shqiptarëve në qoftë se bëhej fjalë për interesat politike të momentit.

### **Sërishmi deputet i Elbasanit**

Ndonëse marrëdhëniet e Shefqet Vërlacit me Ahmet Zogun ishin të tendosura, Sh.Vërlaci gjatë zgjedhjeve të gushtit 1928 për Asamble Kushtetuese sërish u zgjodh deputet i Elbasanit, me mandat 4 vjeçar (1928-1932).

<sup>13</sup> Kastriot Dervishi, *vep. e përm.*, f. 51.

<sup>14</sup> *Gazeta shqiptare*, 8 dhjetor 1927.

<sup>15</sup> Kastriot Dervishi, *Historia e shtetit shqiptar (1912-2005)*, Tiranë: 2006, f.

Më 1 shtator 1928 Vërlaci ishte antar i Komisionit të Asamblesë (dhe përfaqësues i Elbasanit), e cila u transformua në parlament dhe e shpalli Shqipërinë, Monarki Parlamentare. Njëkohësisht ishte dhe deputet i Elbasanit në parlament gjatë legjislaturës së dytë.<sup>16</sup> Kur shohim këtë fakt, natyrshëm nisim të gjykojmë dhe analizojmë se kush ishin ata faktorë, të cilët edhe në ato rrethana, kur midis tij dhe mbretit kishte marrëdhënie mjaft të acaruar, bënë që megjithatë Sh. Vërlaci të dilte sërishmi deputet. Pra të gjejmë rrethana që A. Zogu nuk mund t'i anashkalonte. Mendojmë se pavarësisht marrëdhënieve midis tyre, tashmë Sh. Vërlaci ishte figurë me reputacion shumë të madh politik dhe me një karrierë që nuk mund të injorohej lehtësisht. Këtu nuk mund të përjashtohet edhe ndikimi i fuqishëm që kishte ai në shumë zona të vendit dhe forca e tij e madhe ekonomike.

Nuk e mbështet lëvizjen e fshehtë të Vlorës. Kur përfaqësuesi i Organizatës së Fshehtë të Vlorës pranë qeverisë jugosllave Myqerem Hamzaraj i kishte kërkuar Vërlacit pjesëmarrjen e tij në këtë organizatë, ky i fundit ishte shprehur se nuk i besonte organizatës dhe se Zogu nuk ishte i sëmurë.<sup>17</sup>

Pas shpërbërjes së Organizatës së Fshehtë të Vlorës dhe më vonë dështimit të kryengritjes së Fierit, në vend nisën të formoheshin disa grupime, të cilat ishin kundërshtarë të regjimit ekzistues në Shqipëri. Gjatë vitit 1935 Vërlaci bënte pjesë në grupimin e bejlerëve, kundërshtarë të regjimit zogist, grupim ky, i cili ishte pro Italisë dhe kundër Jugosllavisë.

Më 1 gusht 1937 u zgjodh anëtar i Këshillit Administrativ të Bankës Bujqësore dhe deputet i Elbasanit në parlamentin e dalë nga zgjedhjet që përfunduan më 31 janar 1937.

Armiqësia deri në vdekje mes Vërlacit dhe mbretit Zog, e nisur gjatë vitit 1928 u thellua vazhdimisht në vitet që pasuan. Armiqësia midis tyre arriti deri aty sa që Vërlaci në dhjetor të 1939 i kërkoi Italisë dhe më konkretisht Musolinin që ta lejonin të vriste Ahmet Zogun, gjë që u kundërshtua nga pala italiane duke u justifikuar se një veprim i tillë nuk do të sillte asnjë përfitim.

### **Kryeministër (1939-1941) në periudhën e pushtimit fashist italian të Shqipërisë**

Para mbërritjes së pushtuesve fashistë italianë në qytetin e Elbasanit, Shefqet Vërlaci me anën e forcave të tij të komanduara nga Hajdar Xhika, vuri nën kontroll Prefekturën e Elbasanit me qëllim që të lehtësonte hyrjen e pushtuesve në qytet dhe për të shmangur gjakderdhjen në popull dhe në rininë elbasanase. Në Asamblenë Kushtetuese të 12 prillit 1939 Sh. Vërlaci ishte përfaqësues i Elbasanit dhe pjesëmarrës aktiv në të. Po atë vit ai u zgjodh

<sup>16</sup> Gazeta *Drita*, e enjte, 1 shtator 1938.

<sup>17</sup> Kastriot Dervishi, *Historia e shtetit shqiptar ...*, f. 324.

senator i Mbretërisë Italiane. Më pas më 12 prill 1939 Vërlaci u zgjodh Kryeministër. Pra Sh.Vërlaci për herë të dytë u ngjit në postin e Kryeministrit në vitet 1939-1941 gjatë pushtimit Italian. Ai ishte kryeministri i parë kuisling në Mbretërinë e Bashkuar Italo-Shqiptare me mbret Viktor Emanuelin III. Sh.Vërlaci u vu në krye të shtetit shqiptar duke mbajtur njëkohësisht edhe postin e zëvendësministrit dhe të sekretarit të shtetit për Punët Botore. Mandati i tij në krye të qeverisë zgjati nga 12 prilli 1939 deri në 3 dhjetor 1941.

Pas miratimit më 13 prill 1939 nga Këshilli i Epërm Fashist të bashkimit nga ana e Asamblesë Kushtetuese të Shqipërisë dhe Italisë, duke shpallur vënien në krye të kësaj mbretërie të Viktor Emanuelit, më 16 prill Vërlaci u vendos në krye të delegacionit shqiptar dhe mbajti fjalën e rastit në Romë gjatë dhënies së kurorës shqiptare Viktor Emanuelit. Delegacioni shqiptar përbëhej nga ministër Sekretar Shteti i Partisë Fashiste Shqiptare Tefik Mborja, ministri i Punëve të Jashtme Xhemil bej Dino, ministri i Arsimit Ernest Koliqi dhe nga disa oficerë të lartë shqiptar.<sup>18</sup> Delegacioni nën kryesinë e Vërlacit udhëtoi drejt Brindizit me luftanijen mbretërore “Pessogno”, dhe aty u prit prej autoriteteve të larta civile e ushtarake, nga hierarkët fashistë. Reparte të fuqive armate me flamurë paraqitnin nderimet bashkë me përfaqësitë e Fashios dhe të organizatave të partisë, duke nisur më pas udhëtimin drejt Romës.

Në fjalimin e Sh.Vërlacit mbajtur me këtë rast, ndër të tjera u shfaqën hapur tendencat e tij si italoofil, duke e parë të ardhmen e Shqipërisë përkrah Italisë, si e vetmja shpresë për të ardhmen e saj dhe për përligjen e interesave të tij. Ndër të tjera në këtë fjalim Vërlaci deklaroi: “ Ekselencë, oficerë, nënoficerë e gjindarmë shqiptarë! Ditën që Madhëria e Tij Viktor Emanueli III, Mbreti ynë pranoi ofertën e popullit shqiptar dhe vuri m'ë krye kurorën e Skënderbeut, simbol i krenarisë sonë kombëtare, u konsakrua solemnisht për jetën e jetës, vëllazërimi i dy popujve shqiptarë e italian të lidhur që prej shekujsh nga një miqësi e ngushtë. Këta janë vëllezërit tuaj, ju jeni vëllezërit e tyre. Këta vëllezër më të mëdhenj na sjellin eksperiencën e tyre në çdo fushë të aktivitetit ndërkombëtar dhe sidomos në atë të mbrojtjes së interesave tona jetësore. Çdo patriot shqiptar duhet të ndiejë në thellësinë e shpirtit të vet me frymë vëllazërore këtë bashkim”.<sup>19</sup>

Delegacioni i kryesuar nga Vërlaci, në takimin me Viktor Emanuelin III, i premtoi sovranit vullnetin e plotë të popullit shqiptar me bashkëpunue besnikërisht dhe legalisht në kuadrin e madh të Perandorisë, me Italinë fashiste<sup>20</sup>.

Në momentin kur përfaqësuesi shqiptar në Lidhjen e Kombeve lexon telegramin e Kryeministrit shqiptar Shefqet Vërlaci, lidhur me daljen e Shqipërisë nga ky organizëm, gjë që tregonte më së miri, se mbas gjithë kësaj

<sup>18</sup> *Gazeta e Korçës*, e shtunë, 3 qershor 1939.

<sup>19</sup> *Po aty*, e enjte, 25 maj 1939.

<sup>20</sup> *Po aty*, e enjte, 20 prill 1939.

qëndronte Italia, e cila bashkë me aleatet e saj tashmë ishte përfshirë në konfliktin e ri botëror. Kjo letër mbeti pa përgjigje.

Në 3 prill të vitit 1940 u ndërmor “një hap i madh drejt Shqipërisë moderne”<sup>21</sup>. Sipas shtypit të kohës ky hap i madh konsistonte në Ligjin Vërlaci për gjendjen juridike-ekonomike dhe hierarkike të nëpunësve të shtetit. Po sipas shtypit, ligji u miratua me interesimin e veçantë të Shefqet Vërlacit: “.....Zëri i nëpunësve të shtetit Shqiptar në rreshtat e të cilëve, mund ta thomi shpejt, ndodhen të rinjtë e rendit të parë, më së fundmi me interesimin e Shkëlqesisë së tij Vërlacit, u dëgjua edhe një rregullim i ri po vjen tu japë atyre gjithë mundësitë garancije, jo vetëm në patundshmëninë të nëpunësisë, por edhe në zhvillimin e karrieres në lidhje me meritat personale”.

Si element italoofil, Vërlaci në çdo moment shprehte hapur përkrahjen, simpatinë dhe besnikërinë e tij ndaj Italisë gjatë gjithë kohës që ishte në pushtet si kryeministër pas pushtimit italian në Shqipëri. Kjo vihet re dukshëm si në shtypin e kohës, ashtu edhe në dokumentet e ndryshme, të cilat i përkasin korrespondencave, fjalimeve etj. Sipas Vërlacit, “Drejtësia, rendi dhe mirëqenia janë shprehje të jetës së re që frymëzon sot Shqipërinë në dritën e shkëlqyeshme të bashkimit të sajë me Italinë fashiste, janë shprehje të një kuptimi të posaçëm tue qenë se mund të thuhet që ndoshta sot për herë të parë populli shqiptar në tanësinë e vet sheh të respektueme dhe të njoftun të drejtën t’impozuem dhe të rregulluem rendin në jetën shoqënore dhe gëzon një farë begatije, prodhim i veprimtarisë së tij të vullnetshëmen, barrë e mundëshme nga ndihma solidare e Italisë fashiste”<sup>22</sup>.

Nën ndikimin e drejtpërdrejtë italian, gjatë marsit të vitit 1940 Këshilli Ministror nën kryesinë e senatorit Vërlaci mori një sërë vendimesh, midis të cilëve atë mbi suprimimin e ministrisë së Ekonomisë Kombëtare, atributet e së cilës do t’i besoheshin dy dikastereve të rinj, atij të Bujqësisë e Pyjeve dhe atij të Industrisë e të Tregtisë. Veç këtyre u pranuan projekt dekretligjet mbi formimin e një komisioni për revizionimin e bibliotekave, mbi matrikullimin e përkohshëm të automjeteve dhe administrimin e Marinës Tregtare. U vendos gjithashtu të merreshin masa duke caktuar një komision të posaçëm për kontrollimin e çmimeve të mallrave të domosdoshme për konsum<sup>23</sup>.

Në kushtet e krijimit të Boshtit Romë-Berlin-Tokio dhe të rifillimit të konfliktit të ri botëror, politika shqiptare në kuadrin e politikës italiane ishte pro interesave të kësaj të fundit. Shprehjen e saj mjaft domethënëse kjo do ta gjente edhe në reagimet e krerëve drejtues të politikës shqiptare, siç ishte sidomos rasti i kryeministrit Vërlaci, i cili në ato momente shprehej mjaft entuziast. Në telegramin që i dërgon kontit Çiano, ndër të tjera ai theksonte: “Lajmi i

<sup>21</sup> *Gazeta Tomorri*, e dielë, 7 prill 1940.

<sup>22</sup> *Po aty*, e martë, 16 prill 1940.

<sup>23</sup> *Gazeta e Korçës*, e mërkurë, 13 mars 1939.

përfundimit të Paktit Trianësh, që bashkon fuqitë e të trija Perandorive në detyrën e madhe të rindërtimit evropian e aziatik u mësua në krejt Shqipërinë me krenari e gëzim. Në emër të Qeverisë dhe të emrin personal, ju lutem Shkëlqesisë që në emër të Duçes, jeni një prej faktorëve kryesorë, të pranoni urimet më të gjalla për këtë vepër të re me rëndësi historike shumë të madhe që lidh Italinë, Gjermaninë e Japoninë në të njëjtën përpjekje për t'i gatuar fatet e botës duke vendosur një rend të ri bazuar mbi drejtësinë e vërtetë”<sup>24</sup>.

Në 30 nëntor 1940 vdiq ministri i Drejtësisë Xhaferr Ypi. Pas vdekjes së tij Shefqet Vërlaci u emërua dhe nënsekretar shteti për Drejtësinë. Më 19 janar 1942 Shefqet Vërlaci u emërua ministër Shteti i Italisë.

Në momentet e emërimit të Shefqet Vërlacit si kandidaturë e mundshme për t'u vënë në krye të qeverisë kukull të pushtimit italian, këta të fundit ishin të bindur se ai ishte personi i favorshëm për t'u vënë në këtë post. Por pavarësisht se Vërlaci ishte një italoofil dhe ishte shpesh herë një vegël e bindur e Italisë, pati edhe raste në të cilat ai mbajti një farë distance ndaj tyre. Ndoshta kjo ka të bëjë me prestigjin e madh që kishte ai në elitën e këtij vendi apo edhe në qenien e tij si një ndër personat më të pasur në Shqipëri.

Në opinionet e kontit Çiano lidhur me këtë personalitet ndër të tjera shprehet pas takimit të tij të parë me Vërlacin se: “Unë nuk e njihja Vërlacin, por po ta kisha njohur më parë do ta kisha kundërshtuar emërimin e tij. Ai është shumë hijerëndë dhe duket se do të na shkaktojë shumë kokëçarje”<sup>25</sup>.

Më 27 prill 1940, Vërlaci mori pjesë në ceremoninë e nisjes së punimeve të hekurudhës Durrës-Elbasan, me gjatësi të përgjithshme 90 km, madje ai hodhi kazmën e parë në ajër. Shpenzimet totale për ndërtimin e kësaj hekurudhe kapnin përafërsisht shifrën e 200 milion lira. Sipas shtypit të kohës: “Me fillimin e sotëm të punimeve në Kavajë, pothuajse gjithë pjesa e trugut të parë të hekurudhës që do të shkojë prej Durrësit dhe do të prekë këto vende: Kavajë, Rrogozhinë, Peqin, Elbasan duke marrë fund në Labinot, është në punim e sipër. Në pjesën Durrës-Elbasan hekurudha do të jetë në mënyrë të veçantë e destinuar për transportin e mallrave dhe të pasagjerëve”<sup>26</sup>.

Po gjatë atij viti ai mori pjesë në inagurimin e rrugës automobilistike që lidhte Tiranën me Durrësin. Rruga ishte pagëzuar me emrin “Liktorio”. Në telegramin e dërguar me këtë rast kontit Galeaco Ciano, kryeministri Vërlaci ndër të tjera theksonte: “Tue inaguruem autorrugën “Liktorio”, që lidh më shpejtë Tiranën me Durrësin, tue rrahun gjurmat e rrugës romake “Egnatia”, mendimi ynë mirnjohës drejtohet kah ju Mik ynë i madh që deshte të gjindeshit pranë dy vjet e gjysmë ma parë në fillimin e punimeve të arteries së re të

<sup>24</sup> *Tomorri*, e enjte, 3 tetor 1940.

<sup>25</sup> Bernd Fischer, *Shqipëria gjatë luftës (1939-1945)*, Tiranë: 2000, f. 68.

<sup>26</sup> *Tomorri*, e dielë, 28 prill 1940.

randësishme që dëshmon kujdesjet e vazhdueshme mirëdashëse t'Italisë Fashiste për përparimin e Shqipënisë".<sup>27</sup>

Nga 8-12 shtator 1940 zhvilloi punimet në Tiranë, Kongresi i Parë Bujqësor. Në këtë kongres u krijua një komision nderi i cili kryesohej nga Shefqet Vërlaci dhe antarë të tij ishin: Terenc Toçi, Tefik Mborja, Andon Beça, Piero Parini, Emin Tora.

Në shtator të vitit 1940 Shefqet Vërlaci u nderua me titullin "Honoris Causa" dhe u shpall anëtar i Legës Navale Italiane. Ja si shprehet lidhur me këto shtypi i kohës: "Shkëlqesia e tij Kryeministri, pranoi pardje Prof. Guido Fabris, Fiduciar për Shqipërinë i Legës Navale Italiane, i cili në emër dhe i ngarkuar nga Admirali i disenjuar Armate Shkëlqesia e tij Romeo Bermazhi, kryetar i kësaj Lege i dorëzoi taserin "Honoris Causa" të Legës Navale Italiane"<sup>28</sup>. Ai ishte politikan që e mbështeti idenë për krijimin e një Shqipërie etnike. Shefqet Vërlaci qëndroi në postin e kryeministrit deri në 4 dhjetor 1941, datë që përkon me ardhjen në pushtet si kryeministër të Mustafa Krujës. Largimi i Vërlacit nga posti i kryeministrit ndoshta ka të bëjë me konfliktin e hapur që ekzistonte midis tij dhe Jakomonit, dhe nisur nga kjo ky i fundit vendos në vend të Vërlacit, kryeministrin e ri.

Pas largimit nga posti i kryeministrit Shefqet Vërlaci pati një tërheqje nga jeta politike

### **Largimi i Shefqet Vërlacit nga Shqipëria për në Itali**

Në prag të kapitullimit të fashizmit italian, Sh. Vërlaci u largua nga vendi për në Itali duke marrë me vete djalin Ismailin dhe vajzën Behije, dhe duke lënë në Shqipëri gruan Semiramide Vërlaci dhe vajzat Ferzilet e Mejtap. Djali i Vërlacit, i cili në këtë kohë ndodhej me studime të larta në Romë, paraqiti kërkesën për praninë dhe u pranua të mobilizohej vullnetar në një nga repartet e Milicisë Fashiste Shqiptare<sup>29</sup>.

Në Itali Shefqeti u vendos në Romë ku u bë një ndër organizatorët e Bllokut Kombëtar Independent, grup që u krijua gjatë vitit 1946, (mendohej se organizata ishte vazhduese e organizatës "Nacionalistët" e formuar në Shkodër nga një klerik duke pasur në udhëheqje Gjon Marka Gjonin, Vërlacin etj.), por nuk pati kohë të vihej në drejtim të këtij grupimi për shkak të përkeqësimit të shëndetit. Ky grup u krijua nga emigrantët shqiptarë në Itali pas Luftës së Dytë Botërore me ndihmën e Italisë dhe të Vatikanit. Pjesa më e madhe e atyre emigrantëve jetonin në kampet e ngritura në Itali, por numri më i madh i tyre ishte në "Rexhio Emilia".

<sup>27</sup> *Po aty*, e martë, 27 gusht 1940.

<sup>28</sup> *Po aty*, e mërkurë, 25 shtator 1940.

<sup>29</sup> *Po aty*, e mërkurë, 12 qershor 1940.

Pas vrasjes së Marka Gjonit, organizata u riorganizua në Romë me emër të ri. Nismën për krijimin e saj e mori Ismail Vërlaci, i cili ishte dhe kryetar i saj<sup>30</sup>.

Mund të themi se shumica e tyre pavarësisht se ishin personalitete të njohura në jetën politike shqiptare dhe se ishin mbështetës të regjimit italian në Shqipëri, bënë një jetë të vështirë në këto kampe. Sipas të dhënave, jetë të mirë ka bërë në Itali Ismail Vërlaci, i biri i Shefqet Vërlacit për shkak të pasurisë që i kishte lënë i ati në Itali.

Vërlaci vdiq në një spital të Zyrihut në Zvicër më 21 korrik 1946 dhe u varros në varrezat protestante në Romë, në parcelën dytësore 1537 të këtij qyteti<sup>31</sup>. Gjatë viteve të para të regjimit komunist në Shqipëri u kërkua nga qeveria shqiptare që të ekstradohej në Shqipëri me akuzën si “kriminel lufte”.

### *S u m m a r y*

#### AN OVERVIEW ON THE POLITICAL ACTIVITY OF SHEFQET VERLACI

One of the most distinguished and a wealthy personality of the region of Elbasan was Shefqet Vërlaci. He was descending from one of the powerful families of the region of Elbasan. The power and prestige from the political point of view of this particular figure was apparent during 1912-1939, a period of dense and decisive political activities in the history of the Albanian state. The potential of this personality was partly due to his great wealth possessed as well as his prominent skill as a politician.

This article aims to analyze the political activity of Shefqet Vërlaci, the power and the presence of which was apparent not only within the region of Elbasan but also in a national level. This figure of the region of Elbasan but also with a wider extension of influence of a national scale, beside the political oscillations that were present in the politics of the monist period it was left unmentioned. Furthermore, when considered in the historiography of this period it has been regarded as a traitor, a collaborationist, a bey etc. However this personality needs to be considered with caution due to the reason that it could not be regarded only with negativity, but during particular moments and during discussions in the National Council his opinion and stand were in favour of the country and the people.

Subsequently through this article, it is intended the analysis and consideration of this important figure objectively without politicisation or hyperbolization. Finally we can judge a personality from different perspectives whether positive or negative, finalising what nowadays history is asking for from us.

Most of all needs to be emphasised that this figure for the role that played and the policy that it pursued is by now a constituent part of the local history of Elbasan as well as national.

<sup>30</sup> Kastriot Dervishi, *Historia e shtetit ...*, f. 627.

<sup>31</sup> Po ai, *Elbasani ...*, f. 51.